



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
SEKTORI I PROKURIMEVE

Durrës, më 18.09.2025

PROCESVERBAL
Tipi i kontratës - PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Rindërtimi i Godinës Nr.32, “Fakle”, Rruga “Teodor Rupi”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):

Punë ndërtimi - 45000000-7

Në zbatim të Vendimit të Komisionit Shtetëror Rindërtimit nr.117, datë 20.12.2024, të Ligjit Nr.97/2019 “Për miratimin e Aktit Normativ, me fuqinë e Ligjit, Nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”; Vendimit Nr. 225, datë 12.04.2021 “Për miratimin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit, të kriterëve të vlerësimit të ofertës fituese, kushteve të marrëveshjes kuadër dhe të kontratës për procesin e rindërtimit”, të ndryshuar; për këtë procedurë prokurimi u përdorën dokumentet standarde “Procedurë e përsheptuar – rindërtimi punë”, lloji i procedurës “Tender i Kufizuar (në kuadër të procesit të rindërtimit) të konfirmuar nga Agjencia e Prokurimit Publik si më poshtë:

Në lidhje me procedurat e prokurimit që zhvillohen në kuadër të procesit të rindërtimit, kuadri rregullator, përveç ligjit për prokurimin publik, përfshin Aktin Normativ nr. 9/2019, të miratuar me Ligjin 97/2019, si dhe VKM Nr.225 date 12.04.2021, me anë të të cilit janë miratuar dokumentet standarde të tenderit për këto procedura. Referuar këtyre dispozitave ligjore, hartimi i dokumentet standarde për procedurat e prokurimit për rindërtimin është kompetencë e Ministrit të Shtetit për Rindërtimin, ndërkohë që APP publikon këto dokumente.

Për sa më sipër, autoritetet kontraktore, për procedurat e rindërtimit, do të zbatojnë VKM Nr.225 date 12.04.2021 dhe do të përdorin dokumentet standarde të tenderit të miratuara me këtë vendim, edhe pse në këto DST nuk parashikohet Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.

VLERA E FONDIT LIMIT TOTAL: 505,966,779 (pesëqind e pesë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë) Lek pa TVSH.

Argumentim:

MBI PËRLLOGARITJEN E VLERËS LIMIT TË KONTRATËS SË PROKURIMIT ME TITULL:
“Rindërtimi i Godinës Nr.32, “Fakle”, Rruga “Teodor Rupi”

Në zbatim të urdhrat të grupit të specifikimeve Nr.38, datë 03.02.2025 me Nr.1797 prot. të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, “Mbi Përgatitjen e Specifikimeve Teknike dhe Përllogaritjen e Vlerës Limit për objektin e mësipërm, i ndryshuar me urdher Nr.132, datë 30.05.2025 me Nr.1797/1 prot., të planifikuar për tu kryer në programet e investimeve.

Grupi i specifikimeve teknike, pasi u njoh me objektin e prokurimit:

1. Dokumenteve sipas buxhetit të bashkisë të vitit 2025 të miratuara nga Këshilli Bashkiak, për fondin limit.
2. Dokumentet lidhur me projektin, preventivin e punimeve të hartuar sipas VKM nr.216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve”.

PËRCAKTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, grupi i punës u mbështet në:

Specifikimet teknike të hartuara nga projektuesit: stafi i Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, objekt i këtij prokurimi.

Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit Nr.162 , datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, neni 36.

PËRLLOGARITJA E VLERËS LIMIT TË KONTRATËS

Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin Nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar sipas të cilit:

Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe çmimet ndërkombëtare, të botuara

Grupi i punës u bazua në: projektin dhe preventivin për projekt ide të zbatimit e objektit: “Rindërtim i godinës Nr.32 "Fakle", rruga “Teodor Rupi”, te hartuar nga stafi i Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike

- PREVENTIVI DEMOLIMI I GODINËS NR.32 RRUGA THEODOR RUPI, me vlerë 61,864,363.97 (*gjashtëdhjetë e një milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tre pikë nëntëdhjetë e shtatë*) Lek pa TVSH.
- PREVENTIVI IDE PËR RINDËRTIM I GODINËS NR.32 RRUGA THEODOR RUPI, me vlerë 434,346,551.62 (*katërqind e tridhjetë e katër milion e treqind e dyzet e gjashtë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e një pikë gjashtëdhjetë e dy*) Lek pa TVSH.

Sipas VKM Nr.354, datë 11.5.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

- Mbështetur në tabelën 6 të Nenit 25, “Tabela shoqëruese e tarifave - *Seksioni I, Ndërtesat dhe ndarjet funksionale të tyre*”, Grupi i III tarifar.

Kostoja e llogaritshme e punimeve të sistemeve teknike (sipas preventivit të punimeve dhe prishjes) ka vlerë 496,210,915.59 (katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë milion e dyqind e dhjetë mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë pikë pesëdhjetë e nëntë) Lek pa TVSH.

- Vlera maksimale e të gjithë shërbimit për Faza II: Projektideja paraprake, Faza IV: Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit, Faza V: Projekti i zbatimit dhe Faza VI: Preventivi përfundimtar zë në total 55% për ndërtim të ri të vlerës sipas tabelës Nr.5, Neni 24- Ndërtesat dhe ndarjet funksionale të tyre.

Vlera e projektit është: $17,737,934 \times 55\% = 9,755,864$ (nëntë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e katër) Lek pa TVSH.

Mbështetur në rezultatin e sipërnxjerrë, Komisioni, vendosi që vlera e përgjithshme e kontratës për prokurimin me titull: “Rindërtimi i Godinës Nr.32, “Fakle”, Rruga “Teodor Rupi””, të jetë me vlerë: 505,966,779 (*pesëqind e pesë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë*) Lek pa TVSH.

Projekti do financohet në dy vite të ndarë, për vitin 2025 dhe 2026 nga buxheti i bashkisë.

Afati i realizimit të punimeve është: 24 (*njëzet e katër*) muaj.

Garancia për mbulimin të difekteve, që mund të lindin gjatë shfrytëzimit të objektit, nga ana e firmës të jetë 2 (*dy*) vjet.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Përshkrimin e Ofertës, sipas *Shtojcës 3*;
- b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas *Shtojcës 4*;
- c. Sigurim oferte sipas *Shtojcës 5*;
- ç. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas *Shtojcës 7*;
- d. Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas *Shtojcës 8*;
- dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës *Shtojcës 11*;
- e. Formular vlerësimi sipas *Shtojcës 12*;
- f. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve/makinerive sipas *Shtojcës 13*;
- g. Deklaratë mbi ndërtimet civile dhe industriale sipas aktit normative sipas *Shtojcës 14*;
- gj. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 77, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti Ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 10.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 505.000.000 Lek.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së, i ndryshuar, si dhe nenet 43 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës.

Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në mbështetje të Ligjit 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 64 Deklarata Tatimore; Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2022, 2023, 2024) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së i ndryshuar, të neneve 43, pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe bazuar nënin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Kërkesa për paraqitjen e balanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumnin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2025 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP-së i ndryshuar, si dhe të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.*

Kjo kërkesë bazohet në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. Shlyerja e detyrimeve vendore për vitin 2024 ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendndodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 252.500.000 Lek, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 1.010.000.000 Lek.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve, *të shoqëruara me formular vlerësimi sipas shtojcës 12.*
- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës dhe punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

Aftësitë teknike dhe profesionale te tjerat si me poshtë janë hartuar, vendosur dhe përllogaritur nga projektuesit dhe referuar nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Autoritetet Kompetente, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- a. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Punime të Përgjithshme Ndërtimi

NP. 1-A Punime gërmimi në tokë;

NP.2 - D Ndërtime civile dhe industriale
 NP-7a-A Ujësjiellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje
 NP-11 A Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
 NP-12 -E Punime të inxhinierisë mjedisore

Për punimet speciale të ndërtimit:

N.S.- 1C Punime për prishjen e ndertimeve
 N.S – 2B Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre;
 N.S – 3A Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)
 N.S - 4 D Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknikendërtues.
 N.S- 9 A Punime strukturore speciale
 N.S-14B Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.
 N.S.18-A Punime topogjeodezike;

b. Operatori ekonomik duhet të disponojë licencë projektimi ose të kontrakttojë me kontratë bashkëpunimi një shoqëri projektuese të licencuar sipas rregullores së miratuar me VKM nr. 943, datë 28/12/2016 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrje e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”. Licenca e projektimit duhet të ketë kategoritë si më poshtë:

KATEGORIA E KËRKUAR	PIKAT E KATEGORISE
Kat.2 Projektues Arkitekt	a- Projektim arkitekturor për objekte banimi - objekte industriale - objekte turistike;
	d- projektim peisazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbra, lulishte e parqe;
Kat.3 Projektues Konstruktor	b1) Projektim objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme mbi 5 kate.
Kat.4. Projektues Instalator	a) Projektim të instalimeve hidro-termosanitare;
	b) Projektim të instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme;
	c) Projektim të linjave të rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale;
	f) Projektim të sistemeve kundër zjarrit;
	h- Projektimi i impianteve ngritëse e transportuese

	(ashensore, shkalle levizese, etj.);
	j- Projektim të rrjeteve të telefonise, citofonise, fonise, internetit, TV, access kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit, etj., për objektet civile dhe industriale.
Kat5. Projektues vepra hidraulike	b- Furnizim me ujë - kolektorë shkarkimi
Kat 8.Projektues Gjeodet	a- Rilevime inxhinierike
Kat 9. Studim Gjeologo-Inxhinierik - Hidrogeologjik	b- Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile - ekonomike mbi 5 kate.
Kat 12. Studime të Sizmologjisë Inxhinierike	b- Studime/vlerësime gjeologo-sizmike për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1/a, 2 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”i ndryshuar, në të cilët përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;... 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”si dhe nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilët përcaktohet se: “6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore”;Gjithashtu bazuar dhe në VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” (lidhja 2 dhe 4).

Konkretisht:

Llojet e licencave dhe klasifikimi i tyre janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve dhe vlerën e përlllogaritur të kontratës.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

KATEGORIA E KËRKUAR	PERSHKRIMI I KATEGORISË SIPAS LEGJISLACIONI	ZËRAT E PUNIMEVE QË PARASHIKOHEN TË KRYHEN NË PREVENTIV, QË PËRFSHIHEN NË	NIVELI I KLASIFIKI MIT I KËRKUAR	VLERA E PUNIMEVE QË PARASHIKOHEN TË KRYHEN NË
---------------------	---	---	----------------------------------	---

	T TË FUSHËS	KATEGORINË PËRKATËSE	PËR KATEGORI NË RESPEKTIV E	PREVENTIV, QË PËRFSHIHEN NË KATEGORINË PËRKATËSE
NP. 1-A	Punime gërmimi në tokë;	Gërmim dheu themele e plinta me b>2m, ekskavator me goma 0.25m ³ ,shkarkimi ne auto. Shpim me sondë puse pilotash në zhavorr, Ø 600mm, thellësia deri 5m.	A (0- 20 milionë lekë)	2,203,602.00
NP.2 - D	Ndërtime civile dhe industriale	Pllake themeli, trare e bazamente b/a C 25/30 Soleta b/a me polisterol dhe rrjete teli C 20/25 t=30cm, h~6m Kollona b/a monolite C 25/30 h ~ 4m Soleta b/a C 25/30 t=10cm Mure b/a t = 21-30cm, h ~ 4m C 20/25 Brez b/a C20/25 F.V. Hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm F.V. Hekur betoni periodik Ø > 12 mm F.V. Konstruksione metalike te thjeshta.	D (101 – 200 milionë lekë)	162,498,549.27 lekë
NP-7a-A	Ujësjiellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje	Shpim mikrotunel me drejtim horizontal (HDD)>Ø250mm F.V. Tub drenazhi Ø 150 mm	A (0- 20 milionë lekë)	2,174,284.00
NP-11 A	Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e	KABINE ELEKTRIKE	A (0- 20 milionë lekë)	5,000,000.00

	energjisë.			
NP-12 -E	Punime inxhinierisë mjedisore të	F.V. Mbjellje peme dekorative Bli 16-18cm ne trotuar, (cdo 6m) Transport mbeturinash, nga prishje te brendshme te godines, me krahe Transport mbeturinash me karroce dore ne largesi 40 m Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km Transport dheu me auto deri 5.0 km	A (0- 20 milionë lekë)	7,937,702.35
N.S.- 1C	Punime per prishjen e ndertimeve	Prishje mur tulle me pastrim Prishje shtresa betoni Prishje soleta b/a Prishje mure beton/arme Prishje kollona, trare b/a Prishje shtrese h/izolim tarace	C 51 – 100 milion lekë	56,457,581.33
N.S – 2B	Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre;	PUNIME HIDROSANITARE	B (21-50 milionë lekë)	35,000,000.00
N.S – 3A	Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)	Ashensor	A (0- 20 milionë lekë)	10,000,000.00
N.S - 4 D	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknikendërtues.	Shtrese betoni C 7/10 Shtrese betoni C 12/15 Shtrese stirobetoni Shtrese me pllaka grez importi, 40x40cm Shtrese me pllaka mermeri t=3cm Shtrese me pllaka porcelanat Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama	D (101 – 200 milionë lekë)	154,032,657.99

		Shtrese termoizoluese me polisterol t=10 cm Lyerje betoni me astar me baze poliuretani Hidroizolim me dy shtresa astar me baze cemento. Pergatitur nga dy komponente A+B Veshje kornize llamarine xingat Mur me tulla te lehtesuara dopio deri 8 m, LL.P. M-25 Mur me tulla me 8 vrima, t=10cm h~3m, ll perz M 15 Veshje me pllake majolike Suva brenda mur tulle ~ 4m, me pompe, ll perzier M 25 Suva solete ~ 4 m, me drejtues, me pompe Veshje fasade me polisterol t=5cm + rrjete + suva. F.V. Dyer te brendeshme tamburate te rimesuara Dyer te blinduara F.V. Dritare d/alumini plastike me dopio xham Boje hidroplastike		
N.S- 9 A	Punime strukture speciale	Shpim me sondë puse pilotash në zhavorr, Ø 600mm, thellësia deri 5m Struktura monolite betoni C 25/30 (Pilota) hiqet kallepi nga vlera e cmimit.	A (0- 20 milionë lekë)	3,188,238.08
N.S-14B	Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.	PUNIME ELEKTRIKE	B (21-50 milionë lekë)	35,000,000.00
N.S.18-A	Punime topogjeodezike;	Është kërkuar për arësye të zbatimit të rlevimeve topografike dhe organizim të	A, (21-50 milionë lekë)	

		veçantë dhe punimeve topogjeodezike në objekt.		
--	--	--	--	--

Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale sipas zerave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr persipër të realizojë.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktura dhe Energji, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këto forme është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Duke qenë se lloji kontratës është me çelës në dorë, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Kategoritë janë kërkuar bazuar në detyrën e projektimit, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pikat e kategorise	Pershkrimi per kategorite
Kat.2 Projektues Arkitekt	a- Projektim arkitekturor për objekte banimi - objekte industriale - objekte turistike;	Projektim arkitektonik i godines qe do te rindertoet dhe ambienteve ndihmese qe do te ndertohen etj.
	d- projektim peisazhi, sistemim siperfaqe të gjelbera, lulishte e parqe;	Projektim i sistemeve te jashtme.

Kat.3 Projektues Konstruktore	b1) Projektim objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme mbi 5 kate.	Projektim i strukture beton arme qe do te ndertohen, me lartesi deri ne 11 kate.
Kat.4. Projektues Instalator	a) Projektim te instalimeve hidro-termosanitare;	Projektim i instalimeve hidro-termosanitare
	b) Projektim te instalimeve termoteknike- kondicionimi, si dhe te impianteve te prodhimit te energjise termike nga burime te rinovueshme;	Projektim i instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe te impianteve te prodhimit te energjise termike nga burime te rinovueshme;
	c) Projektim te linjave e rrjeteve elektrike, per objekte civile e industriale;	Projektim i linjave te rrjeteve elektrike.
	f) Projektim te sistemeve kundra zjarrit.;	Projektim i sistemeve te mbrojtjes nga zjarri, me sisteme qendrore hidraulike apo me bombula.
	h- Projektimi i impianteve ngritese e transportuese (ashensore, shkalle levizese, etj.);	Projektim i ashensoreve, ne godine
	j- Projektim te rrjeteve te telefonise, citofonise, fonise, internetit, TV, access kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit te zjarrit, etj., per objektet civile dhe industriale.	Projektim i sistemeve te alarmit dhe detektimit te tymit, sistemeve te internet telefonise etj. Cdo instalim tjeter i telefonise, fonise, access kontroll ne keto kategori objektesh
Kat5. Projektues vepra hidraulike	b- Furnizim me ujë - kolektorë shkarkimi	Projektim i rrjetit inxhinierike te kanalizimeve dhe lidhjes me rrjetin e ujesjellesit.
Kat 8.Projektues Gjeodet	a- Rilevime inxhinierike	Rilevime inxhinierike per efekt te aplikimeve per leje ndertimi apo procedurave te ngjashme te parashikuara ne projektimin e godines
Kat 9. Studim Gjeologo-Inxhinierik - Hidrogjeologjik	b- Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile - ekonomike mbi 5 kate.	Studim dhe vleresim i gjeologjis se truallit ku do te ndertohet objekti i ri max deri ne lartesine 11kate

Kat 12. Studime të Sizmologjisë Inxhinierike	b- Studime/vlerësime gjeologosizmike për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore.	Studim dhe vlerësimi gjeologosizmike të truallit ku do të ndërtohet objekti i ri max deri në lartësinë 11kate
--	--	---

Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr për sipër të realizojë.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktura dhe Energji, Republika e Shqipërisë.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi profil Strukturist 2 (dy)
- Inxhinier Ndërtimi 1(nje)
- Arkitekt 1(nje)
- Inxhinier Mekanik 2 (dy)
- Inxhinier Hidroteknik 2 (dy)
- Inxhinier Gjeodet (Topograf) 2 (dy)
- Inxhinier Elektrik 2 (dy)
- Inxhinier Gjeoteknik 1 (nje)
- Inxhinier Mjedis 1 (nje)

Për stafin e sipërcituar, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratat e punës individuale, të vlefshme.
- Diplomën përkatese.
- Libreze pune.
- Të paraqiten listpagesat e E-Sig të shoqërisë minimalisht të 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave, ku punojësit e mësipër duhet të figurojnë .
- Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, i ndryshuar, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohen papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit, për sa i takon ndalimeve të dypunësimit.
- Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

- Inxhinieri Mekanik Drejtues teknik duhet te jete i pajisur me – Certifikim **“Inspektues per Vincat kull”** e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të licencuara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Inxhinieri Elektrik drejtues teknik i pajisur me - Certifikatë CCTV e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të licencuara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, mjedisi, hidroteknik, etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar si me siper, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Drejtuesit Teknik te punimeve në objekt, duhet të jenë te përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të mos jenë te angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në VKM-ne Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohen papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit, konkretisht: Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në

çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohej të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “Elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohej ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën Profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Ne punimet ndërtimore, si pasojë e zerave të ndryshme që përfshijnë larmishmeri punimesh, si dhe referuar zerave të preventivit, rezulton se është e domosdoshme që çdo ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinier Ndërtimi profil Strukturist, Inxhinier Ndërtimi Arkitekt, Inxhinier Mekanik, Inxhinier Hidroteknik, Inxhinier Gjeodet (Topograf), Inxhinier Elektrik, Inxhinier Gjeoteknik dhe Inxhinier Mjedis. Nderkohe që Inxh Mjedisit është e domosdoshme në këtë prokurim për arsye se duhet për garantimin e cilësive të punimeve në përputhje me kërkesat e mjedisit përreth në mënyrë që punimet të mos shkaktojnë ndikim në mjedis. Qëndrueshmëria e tij në punë me kohështrirje për periudhën e 3 muajve të fundit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Punimet apo veprimtaritë konkrete, të cilat lidhen edhe me kategoritë e licenses, për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale:

2 (dy) Inxhinier Ndërtimi profil Strukturist	Janë përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve konstruktive të objektit që prokurohet të cilave i korrespondjnë kategoritë NP-1, NP-2, NS-1, NS-4, NS9. Gjithashtu dhe për hartimin e projektit konstruktiv të objektit të cilave i korrespondjnë kategoritë 12.a duke qenë se kontrata është me celsa në dorë.
--	---

1 (nje) Inxhinier Ndërtimi	Eshtë përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivit të punimeve (<i>Punime ndërtimi, Germimi, Prishje</i>), te cilave i konrrespondjne kategorite NP-1, NP-2, NS-1, NS-4.
2 (dy) Inxhinier Hidroteknik	Eshtë përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve <i>Hidrosanitare, Kanalizime</i> , te cilave i konrresponndon kategoria NS-2 dhe NP-7
2 (dy) Inxhinier Elektrik	Eshte përgjegjës për punimet e rrjetit të brendshëm elektrik dhe telefonise, te cilave i konrresponndon kategoria N.S- 14. Inxhinieri Elektrik Drejtues teknik duhet të jete i pajisur me – Certifikim “ Certifikatë CCTV ” e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të licencuara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë duke qene se objekti do ndertohet me standarte me te larta dhe duhet te kete nje rrjete moderne . Certifikata CCTV është një mënyrë për të siguruar që personi përgjegjës ka ekspertizën dhe nuk është vetëm një titull.
2 (dy) Inxhinieri Mekanik	Inxhinieri Mekanik është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të preventivit për instalimin e kaldajes, punime që përfshihen në kategorine NS-12. Inxhinieri Mekanik Drejtues teknik duhet të jete i pajisur me – Certifikim “ Inspektues për Vincat kull ” e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të licencuara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë duke qene se objekti do priset në mënyrë mekanike dhe vinxh kulla është i nevojshëm për të gjithë fazat e realizimit të objektit si në demolimi, e objektit ekzistues ashtu dhe në rindërtimin e objektit të ri 11 kate.
2 (dy) Inxhinier Gjeodet	Eshtë përgjegjës për zbatimin e saktë të kuotave të projektit në ndërtimet e reja që do të kryhen, te cilave i konrresponndon kategoria NS-18.
1 (nje) Inxhinier ndërtimi profili gjeoteknik	Inxhinier ndërtimi profili gjeoteknik është i nevojshëm pasi do hartohet dokumentacioni teknik i strukturave dhe bazamentit natyral tokë, e cila ka një problematike specifike për heqjen e shtresave sipërfaqesore në sipërfaqen e se ciles do të ndërtohet objekti për të arritur në shtresat rrenjesore të tokës, ka të domosdoshëm prezencën

	e nje inxhinieri ndertimi te profilit gjeoteknik qe te jete prezent ne proceset e punes se ndertimit te bazamenteve, themeleve dhe ne projektimin e objektit.
1 (nje) Inxhinier Mjedisi	Inxhinier ndertimi profili gjeoteknik eshte i nevojshem pasi do te hartohet projekti duke qene se kontrqtq do jete me celesa ne dore, Referuar në preventivin e Punimeve paraprake si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës NP12.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklarate (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë **Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt**, i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Bashkelidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe b) Diploma.

Ne rastin e Bashkimit te Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet te përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe te jetë i pranishem gjate gjithe kohes qe do te kryhen punimet ne objekt ne varesi te vleres se preventivit te punimeve qe ka marre persiper sipas përqindjes se bashkepunimit.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c” dhe duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “ Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik te sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike,

që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajftueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dipsozitave ligjore në fuqi.

2.3.5 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- a. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1 (një) punonjës specialist që të disponojë certifikatë si “Ekspert për Ndihmën e parë dhe Nderhyrjen ndaj Emergjencave” nga kryqi i kuq ose organe të akredituar të njohur nga Republika e Shqipërisë. Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: • Diplomë/certifikatë • Kontratë Pune të vlefshme.
- b. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1 (një) punonjës specialist që të disponojë certifikatë e trajnimit si “Për përgjegjësinë për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë. Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: • Diplomë/certifikatë • Kontratë Pune të vlefshme.
- c. Operatori ekonomik ofertues duhet të kenë në stafin e tyre 1 (një) punonjës me certifikatë “Koordinator i Sigurisë dhe shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: • Diplomë/certifikatë • Kontratë Pune të vlefshme.

- d. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1 (një) punonjës “Ekspert Zjarrfikës i pajisur me Licence I.2.A në përputhje me pikën 4, të nenit 49, të Ligjit Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”. Për këtë duhet të paraqitet Certifikatë/dëshmi për ekspert zjarrfikës të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, diploma dhe kontrata notoriale e punës.” Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:
 - Diplomë/certifikatë • Kontratë Pune të vlefshme.
- e. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1 (një) punonjës specialist që të disponojë certifikatë Për Testimin e Performances së Materialeve/Produkteve të Ndërtimit /Inxhinier Materialeve.” lëshuar nga organe të akredituar të njohur nga Republika e Shqipërisë. Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:
 - Diplomë/certifikatë • Kontratë Pune të vlefshme.
- f. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1 (një) punonjës “Auditues Energjetik” lëshuar nga Agjencia Eficiencës Energjetike, për të kryer auditime në Ndërtesa është i domosdoshëm pasi për objektin që do të nënshtrohet punimeve për ndërtim do të nevojitet Studimi për Eficiencën e Energjisë. Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:
 - Diplomë/certifikatë • Kontratë Pune të vlefshme.
- g. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1 (një) punonjës të pajisur me certificate të “Vlerësimi i ndikimit në mjedis” lëshuar nga organe Ministria e Mjedisit., gjykohet si i domosdoshëm për realizimin e VNM (Vlerësimet e ndikimit në Mjedis) në fazën e realizimit të projektit të zbatimit. Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:
 - Diplomë/certifikatë • Kontratë Pune të vlefshme.
- h. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1 (një) “Mjek” lëshuar nga organe të akredituar të njohur nga Republika e Shqipërisë. Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:
 - Diplomë/certifikatë • Kontratë Pune të vlefshme.

Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë punojësit e mesipër, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë një listë personeli kryesor të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar stafin teknik të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”

bazuar ne perlllogaritjen e oreve te punes , kategorite e punimeve te percaktuara ne preventive, specifikimet teknike te objektit, detajeve te projektit dhe tipologjia e zerave te punimeve , te cilat lidhen ngushtesisht me listen e stafit teknik te kerkuar nga AK, si edhe bazuar ne dosmosdoshmerine e realizimit sa me shpejt te objektit.

- *Kërkesa per punonjes te pajisur me çertifikate “**Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave**” e cila të jetë e lëshuar nga shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certificate. Natyra e kontratës së punimeve që kryhen shihet e nevojshme dhe e domosdoshme prania e 1 (një) Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave.*
- *Kërkesa per “**Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë**”, mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM-ne Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores - Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë, sidomos ne kete kontrate ku dhe numuri i punojesve te kerkuar per realizimin e saj eshte i larte. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM-ne Nr.312/2010 është përcaktuar se: “Punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.”*
- *Kërkesa per “**Koordinatori i Sigurisë dhe shëndetit në punë**”: Roli i Koordinatorit është i fokusuar në koordinimin dhe harmonizimin e masave të sigurisë midis punëtorëve dhe menaxhimit, veçanërisht në projekte zbatimi ku ka disa punonjës ose ekipe që duhet të bashkëpunojnë. Detyra e tij është të sigurojë që të gjitha palët (punonjësit dhe kontraktorët) janë të sinkronizuar me protokollet e sigurisë dhe se bashkëpunojnë për të eliminuar rreziqet potenciale. Ky rol është më i zakonshëm në kantieret e ndërtimit dhe vendet ku koordinimi midis grupeve të ndryshme të punës është kritik për sigurinë e përgjithshme të projektit. 15 Në përmbledhje, Përgjegjësi ka një rol më të përgjithshëm dhe mbikëqyrës për sigurinë, ndërsa Koordinatori fokusohet në aspektet e sinkronizimit dhe organizimit të përbashkët të masave të sigurisë në projekte apo ambiente pune komplekse.*
- *Kerkesa per punojësin i cili duhet të jetë i pajisur me çertifikatë “**Ekspert Zjarrfikës**” ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin në përputhje me klauzolat Ligjit Nr.*

152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin", Neni 49, pika 4, - Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së jep certifikatë për personat fizikë e juridikë për ushtrimin e aktivitetit të ekspertit zjarrfikës privat, në bazë të kriterëve të veçanta të miratuara me udhëzim të ministrit.

- Kërkesa per punonjës **“Specialist për Testimin e Performances së Materialeve/Produkteve të Ndërtimit”**, është një masë e arsyeshme dhe e domosdoshme për të garantuar cilësinë dhe sigurinë e produkteve të ndërtimit. Testimi i performancës së produkteve të ndërtimit është një proces i rëndësishëm për të siguruar që materialet e përdorura në ndërtim përmbushin standardet e cilësisë dhe sigurisë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për të shmangur defekte strukturore dhe për të garantuar jetëgjatësinë e ndërtesave. Rregullorja e BE-së Nr. 305/2011 përcakton kushtet për vendosjen në treg të produkteve të ndërtimit dhe kërkon që performanca e tyre të vlerësohet sipas standardeve të harmonizuara. Kërkesa për një punonjës të certifikuar siguron që procesi i testimit të kryhet në përputhje me këto rregullore. Një certifikatë e tillë ndihmon në minimizimin e rreziqeve ligjore dhe financiare që mund të lindin nga përdorimi i produkteve të ndërtimit me cilësi të ulët. Ky kriter jo vetëm që është i arsyeshëm, por edhe i domosdoshëm për të siguruar që produktet e ndërtimit të jenë të testuara dhe të certifikuara sipas standardeve më të larta
- Kërkesa per Kërkesa per **“Audituesi i energjise”** eshte i nevojshem per hartimin e raportit mbi vleresimin e eficeses se energjise, sipas parashikimeve te nenit 16, pika 2 dhe 3 te ligjit nr. 124/2015 **“Per eficencen e energjise”** parashikohet se: **“2. Auditimi energjetik shoqerohet me nje raport qe perfshin: a) nje vleresim te nivelit aktual te konsumit te energjise per objektin e auditimit energjetik; b) propozimin e masave te kursimit te energjise qe duhen marre, perfshire justifikimin ekonomik; c) te dhena per sasine totale te kursimeve te mundshme; ç) opinionin perfundimtar te audituesit energjetik per potencialin per rritjen e eficeses se energjise dhe masat teknike perkatese. 3. Audituesi i dergon nje kopje te raportit te auditimit energjetik Agjencise per Eficencen e Energjise per ata konsumatore qe jane subjekt i auditimit te detyrueshem”**.
- Kërkesa per Inxhinierin e pajisur me certifikate **“Vleresimi i Ndikimit ne mjedis”**, mbështet në ligjin Nr. Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 **“ PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS”** Ky ligj ka për qëllim të sigurojë:
 - a) një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projekte të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim,.”
 - b) garantimin e një procesi të hapur vendimmarrjeje, gjatë identifikimit, përshkrimit dhe vlerësimit të ndikimeve negative në mjedis, në mënyrën dhe kohën e duhur; si dhe përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara në të.

- **Kërkesa për "Mjekun"** bazohet në marrjen e masave për garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, në zbatim të nenit 23 të ligjit Nr.10 237, datë 18.02.2010 *"Për sigurinë dhe shëndetin në punë"* në të cilin përcaktohet se, citojmë: *"1. Çdo punëdhënës i një subjekti publik apo privat, vendas apo i huaj, është i detyruar të mbulojë me shërbim mjekësor, nëpërmjet mjekut të punës, të përshtatshëm për rreziqet që paraqet vendi i punës."*, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.108, datë 09.02.2011 *"Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë"* (i ndryshuar me VKM-në nr.632, datë 15.07.2015), në të cilin ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: *"7. Personi përgjegjës, i ngarkuar nga shërbimi i specializuar jashtë ndërmarrjes për menaxhimin e riskut, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:...* b) *në lidhje me shëndetin në punë të ketë formim profesional në fushën e mjekësisë së përgjithshme dhe i cili: b.1 të jetë kualifikuar si mjek i sëmundjeve profesionale/mjek pune; b.2 të jetë i licencuar nga Urdhri i Mjekut për ushtrimin e profesionit;..."* duke qënë se është detyrim ligjor mbulimi me shërbim mjekësor të ndërmarrjes nga ana e punëdhënësit, dhe mbulimi i këtij shërbimi në aspektin shëndetësor duhet të kryhet nga mjeku i punës i licencuar, njësia e prokurimit vlerëson se kërkesa për disponimin e mjekut të ndërmarrjes ose të kontraktuar është një detyrim ligjor për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar në përputhje me ligjin, duhet vërtetojnë disponimin e tij.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

Punonjes Staf Teknik

- | | |
|---|--------------|
| - Teknik Ndërtimi (Diplome e shkolles mesme) | 2 (dy) |
| - Teknik i mesem Topograf (Diplome e shkolles mesme) | 2 (dy) |
| - Specialist punime në Skela/Lartesi | 20 (njet) |
| - Specialist kapote ETICS / EPS | 10(dhjet) |
| - Teknik i mesem Mekanik (Diplome e shkolles mesme) | 1(nje) |
| - Teknik i mesëm Elektrik (Diplome e shkolles mesme) | 1(nje) |
| - Teknik i mesëm Termohidraulik (Diplome e shkolles mesme) | 1(nje) |
| - Hidraulikë(Me Certifikate Trajnimi / Diplome) | 5 (pese) |
| - Elektricitet(Me Certifikate Trajnimi / Diplome) | 5 (pese) |
| - Betonues (Me Certifikate Trajnimi / Diplome) | 10 (dhjete) |
| - Karpentier(Me Certifikate Trajnimi / Diplome) | 10 (dhjete) |
| - Hekurkthyes (Me Certifikate Trajnimi / Diplome) | 10(dhjete) |
| - Hidroizolues/Punonjes Catie (Me Certifikate Trajnimi / Diplome) | 5 (pese) |
| - Bojaxhi (Me Certifikate Trajnimi / Diplome) | 5 (pese) |
| - Murator/Suvatues (Me Certifikate Trajnimi / Diplome) | 7 (shtate) |

- | | |
|---|--------------|
| - Pllakashtrues (Me Certificate Trajnimi / Diplome) | 5 (pese) |
| - Termoizolues(Me Certificate Trajnimi / Diplome) | 5 (pese) |
| - Shofer | 3 (tre) |
| - Punëtores ndertimi te thjeshte | 10 (dhjete). |

Punonjes Manovrator

- | | |
|----------------|---------|
| - Eskavatorist | 2 (dy) |
| - Automakinist | 5(pese) |

Për keta punonjes, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë :

- kontratën individuale të punës;
- një dokument (diplomë profesionale/certificate që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë ose ekuivalente.
- certificate te sigurimit teknik e lëshuar nga shoqeri te akredituara nga DPA ose nga organizmat ekuivalente nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.
- Për punonjesit shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:
Kontratën individuale të punës te vlefshme; leje drejtimi, certificate e aftesise profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR.) (Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listepagesat e shoqërisë).
- Për punonjesit Manovratorët duhet të jenë punonjës te specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda dhe për këtë duhet të paraqesin deshmë nga Drejtoria e Sherbimit te Transportit Rrugor. Kërkesa per deshmite e manovratoreve bazohet ne Urdhërin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr.200, datë 16.5.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi I përdorimit të makinerive të ndërtimit”
(Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listepagesat e shoqërisë).
- Për punonjesit e krahut , ofertuesi duhet të paraqesë kontratën individuale të punës te vlefshme .

Operatori ekonomik ofertues duhet të plotësoj Deklarata “*Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate*”, operatorët ekonomik per punonjesit e mesiperm **duhet të deklarojnë**: emer/mbiemer, profilin e punes, subjektin lëshues te certificates/diplomes, Nipt (ne rastin kur subjekt lëshues i certificates/diplomeseshte privat) dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1				
2				
etj				

Shenim: Ne rast mos plotesimi sipas fotmatit te kerkuar eshte kusht skualifikimi.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të percaktuara në specifikimet teknike. Zbatimi i punimeve që përfshin projektin duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse të lëshuara nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) të lëshuara nga Inspektorati Shtetëror Teknik. Certifikimet /diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të regjistruara në “rregjistrat profesionale” të AKAFP-se. Percaktimi i numrit të punonjësve dhe profesionet është bazuar mbi zërat dhe volumet e punes si dhe afateve për perfundimin e punimeve, në mbështetje të Manualit të ndertimit miratuar me Vendim nr.629, datë 15.07.2015 (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në kriter elementet e strukture së kostos (material, puntori, makineri, transport). Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

- **Tekniku i ndërtimit** është i nevojshem për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivit të punimeve, sic janë germimet, punimet e shtresave, punimet e betonit, punimet e muratures etj, lexon dhe kontrollon zbatimin e projektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit (KTZ), implementon kërkesat dhe direktivat e inxhinierit dhe ndan detyrat për punetoret dhe ndjek ecurinë e tyre gjatë kohës së punës. Tekniku duhet të disponojë Diplome e shkolles mesme.
- **Tekniku topograf** është i nevojshem për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, për zbatimin e saktë të kuotave të projektit në ndërtimet e reja që do të kryhen duke asistuar drejtuesin teknik. Tekniku duhet të disponojë Diplome e shkolles mesme.
- **Teknik i mesëm Mekanik** është i nevojshem për ndjekjen e realizimit të punimeve të instalimit të pajisjeve mekanike (ashensor) për kordinimin dhe kontrollin e sinjalistikës në kantier duke asistuar drejtuesin teknik. Tekniku duhet të disponojë Diplome e shkolles mesme.
- **Teknik i mesëm Elektrik** është i nevojshem për ndjekjen e realizimit të punimeve të instalimit elektrik të objektit për kordinimin dhe kontrollin në kantier duke asistuar drejtuesin teknik. Tekniku duhet të disponojë Diplome e shkolles mesme.
- **Teknik i mesëm Termohidraulik** është i nevojshem për ndjekjen e realizimit të punimeve të instalimit të enëve nën presion të objektit për kordinimin dhe kontrollin në kantier duke asistuar drejtuesin teknik. Tekniku duhet të disponojë Diplome e shkolles mesme.
- **Specialist punime në Skela/Lartësi** është i nevojshem për realizimin të punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivit të punimeve, sic janë suvatime, llyerje me boje në fasade, sistemi kapote, prishje, etj... Punonjës/specialistë të çertifikuar për “*Punime në lartësi*”, sipas VKM-së Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, e dhënë nga një organizëm i licencuar çertifikimi shqiptar ose i huaj. Numri i kërkuar është bazuar në grafiku i punimeve, ku volumi më i madh i punimeve në ndërtëse. **Specialist punime në Skela/Lartësi** duhet të disponojë Certificate Trajnimi / Diplome.
- **Specialist kapote ETICS / EPS** është i nevojshem për realizimin e punimeve të kapotes ETICS / EPS, sipas zërave të preventivit të punimeve. **Specialist kapote ETICS / EPS** duhet të disponojë Certificate Trajnimi / Diplome.
- **Hidrauliku** është i nevojshem për realizimin e punimeve hidraulike, sipas zërave të preventivit të punimeve. Numri i kërkuar është bazuar në grafiku i punimeve, ku volumi më i madh i punimeve hidraulike në ndërtëse dhe në punimet e jashtme. Hidrauliku duhet të disponojë Certificate Trajnimi / Diplome.
- **Elektrici** është i nevojshem për realizimin e punimeve elektrike, sipas zërave të preventivit të punimeve. Numri i kërkuar është bazuar në grafiku i punimeve, ku volumi më i madh i punimeve elektrike. Elektrici duhet të disponojë Certificate Trajnimi / Diplome.
- **Betonuesi** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të betonit sipa zërave të preventivit. Ndihmon në ndërtimin e armaturës brenda së cilës do të derdhet betoni, vendosin shtyllat mbajtëse të peshës, morsetat dhe mjetet e tjera që sigurojnë qëndrueshmërinë e armaturës

ndaj peshës dhe presionit të ngarkesës beton, Shpërndajnë betonin dhe e shtrojnë atë në soleta, kolona, shkallë, mure, ballkone, ura, apo strukturave të tjera në kohën e duhur, sipas radhës së përcaktuar nga projekti dhe drejtuesi teknik i objektit, bëjnë vibrimin e betonit gjatë çdo betonimi, kryejnë nivelimin e betonit, kryejnë lustrimin e betonit apo çimentos. Numri i kerkuar është bazuar te grafiku i punimevedhe volumit te punimeve. Betonues duhet te disponoje Certificate Trajnimi / Diplome.

- **Karpentierët** janë të nevojshëm për punimet beton arme, punime themeli, kollona e soleta sipas zerave te preventivit. Bejne pike timin dhe armaturen anesore te themelit, bejne vendosjen e modinave per kolonat dhe muret e betonit, ndertojne armaturen, kallepet e kolonave, mureve, montojne skelerine perforcuese per fazen e betonimit te mureve dhe kolonave, prerjen dhe montimin e strukturave prej druri e metali si dhe ndërtimin e kornizave dhe strukturave të tjera përforcuese prej druri, bashkimin dhe montimin e elementëve metalik apo materiale të tjera, të nevojshme për realizimin e objektit që do të ndërtohet. Numri i kerkuar është bazuar te grafiku i punimevedhe volumit te punimeve. Karpentierët duhet te disponoje Certificate Trajnimi / Diplome.
- **Hekurkthyesit** janë të nevojshëm për përzgjedhjen, prerjen, kthimin dhe vendosjen e hekurit, për realizimin zërave të punimeve te hekur betonit sipas preventivit. Numri i kerkuar është bazuar te grafiku i punimevedhe volumit te punimeve. Hekurkthyesi duhet te disponoje Certificate Trajnimi / Diplome.
- **Hidroizolues/Punonjes Catie** janë të nevojshëm për punimet e hidroizolimit sipas zerave te preventivit. Numri i kerkuar është bazuar te grafiku i punimevedhe volumit te punimeve. Hidroizolues duhet te disponoje Certificate Trajnimi / Diplome.
- **Bojaxhijt** janë të nevojshëm për realizimin e punimeve të lyerjes me boje sipas zërave të preventivit të punimeve. Kryen përgatitjen e sipërfaqeve të ndërtesave dhe strukturave të tjera për lyerje, kryen përgatitjen e materialeve që do të përdoren për lyerje, bejne stukime, zmerilime, pastrime, kryejnë lyerjen me astar të sipërfaqes për lidhjen e saj me bojën, kryejnë lyerjen përfundimtare të sipërfaqeve me ngjyrat e përgatitura, bëjnë lyerjen me materiale përkatëse dhe bojëra mbrojtëse të sipërfaqeve të drunjta, të strukturave metalike, kornizave të hekurta të ndërtesave. Numri i kerkuar është bazuar te grafiku i punimevedhe volumit te punimeve. **Bojaxhijt** duhet te disponoje Certificate Trajnimi / Diplome.
- **Suvatues** janë të nevojshëm për realizimin e punimeve te suvatimit sipas zërave të preventivit. Kryejnë vendosjen e një ose më shumë shtresave të suvasë në muret e brendshme dhe në tavanet e godinave duke realizuar një sipërfaqe të lëmuar. **Muratori** është i nevojshëm për realizimin e punimeve te muraturës, soletave etj. sipas zërave të preventivit. Bëjnë pike timin e mureve të objektit, bëjnë përgatitjen e sasisë së nevojshme të llacit për procesin ditor të punës, bëjnë breza përforcues betoni në gjysmën e lartësisë së murit ose sipas specifikimit në projekt; kontrollojnë nëse muret janë të lidhur midis tyre horizontalisht dhe vertikalisht duke garantuar kështu qëndrueshmërinë e tyre, ndërtojnë soletat, vendosin arkitrarët e dyerve dhe dritareve, bëjnë mbushjen me llac të mureve në nivelin e fashove me

dorë ose me pompë në varësi të materialit të përcaktuar nga drejtuesi teknik në objekt, përgatitin materialin e nevojshëm për tavane me gips apo për tavane të varura zbukurues duke bërë matjet dhe prerjet e duhura. Numri i kerkuar eshte bazuar te grafiku i punimevedhe volumit te punimeve. **Suvatues/ Muratori** duhet te disponoje Certificate Trajnimi / Diplome.

- **Pllakashtrues** janë të nevojshëm për realizimin e punimeve të shtrimit te pllakave sipas zërave të preventivit të punimeve. Numri i kerkuar eshte bazuar te grafiku i punimevedhe volumit te punimeve. **Pllakashtruesi** duhet te disponoje Certificate Trajnimi / Diplome.
- **Termoizoluesit** janë të nevojshëm për zbatimin e projektit ne termozolimin e elementeve te ndertesese si muratur, tavane,tubacione, dyer-dritare, etj.. Ata dihmojnë në përmbushjen e standardeve të efijencës energjetike (p.sh., VKM 285/2021 në Shqipëri për ndërtesat). Numri i kerkuar eshte bazuar te grafiku i punimevedhe volumit te punimeve. Termoizoluesit duhet te disponoje Certificate Trajnimi / Diplome.
- **Shoferi** eshte i nevojshem për drejtimin e mjeteve si kamione, kamionçina. Numri i kerkuar eshte bazuar te grafiku i punimevedhe volumit te punimeve. **Shoferi** duhet te disponoje leje për drejtimin e mjeteve si kamione, kamionçina.
- **Manovratori eskavatorist** eshte i nevojshem per përdorimin e makinerive të renda te ndertimit si eskavator germimi dhe fadroma te te gjitha llojeve, te cilat jane kerkuar pasi ne preventiv jane parashikuar punime qe kerkojne perdorimin e ketyre makinerive. Ne nenin 8, germa a, të rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës percaktohet: Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas Dëshmimeve të Aftësive Profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë:

a)-eskavator germimi e ngarkimi dherash të të gjitha llojeve si dhe fadromat e të gjitha llojeve (me goma dhe me zinxhirë), manovratorëve u jepet dëshmi për **ESKAVATORIST**.

- **Manovratori automakinist** eshte i nevojshem per përdorimin e makinerive të renda te ndertimit si autobetoniere, autovinca, autopompe betoni, te cilat jane kerkuar pasi ne preventiv jane parashikuar punime qe kerkojne perdorimin e ketyre makinerive. Ne nenin 8, germa c, të rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës percaktohet: Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas Dëshmimeve të Aftësive Profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë:

c)-Automjete për përdorim të veçantë (APV) sipas pikës “g”, të nenit 54, të Kodit Rrugor, makineri ndërtimi mbi bazë automjeti:-**autovinça, autobetonierë, autopompa betoni, autobitumatriçe, autosonda, autotokmak**, manovratorëve u jepet dëshmi për **AUTOMAKINIST**.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht **146 (njëqind e dyzet e gjashtë)** persona, për një periudhë 3 muajore nga data e zhvillimit të tenderit. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë dokumentacionin si më poshtë :

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj .
- Listë pagesat e punonjësve, të konfirmuara nga institucionet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualit teknik të cmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre “(perlllogaritja e oreve të Punes si edhe të mjeteve të nevojshme) , Kodi i Punes në RSH , si edhe bazuar në dosmosdoshmerine e realizimit sa më shpejt të objektit. Komisioni i perlllogaritjes së vlerës së fondit limit dhe përgatitjes së dosjes teknike kanë analizuar dhe perlllogaritur numrin minimal të punëtorëve prej 146 punonjësish mesatarisht të dosmosdoshëm për realizimin e objektit të prokurimit në një afat kohor 24 muaj (2 muaj projekti i objektit+ leja e ndërtimit , 6 muaj prishja e objektit ekzistues dhe 16 muaj ndërtimi i objektit).

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i Makinerive	Pronësia	Sasi
1	Eskavator me zinxhir min 18 ton	Pronesi ose me qera	3 copë
2	Ekskavator me goma (mjet teknologjik me goma)	Pronesi ose me qera	1 copë
3	Eskavator me zinxhir 5-7.5 ton	Pronesi ose me qera	1 cope
4	Eskavator me zinxhir 1.5-2.5 ton	Pronesi ose me qera	1 cope

5	Eskavator me krah te gjate min 18m	Pronesi ose me qera	1 copë
6	Çekic eskavatori 100-500kg	Pronesi ose me qera	1 copë
7	Çekic eskavatori 501-1000 kg	Pronesi ose me qera	1 copë
8	Çekic eskavatori min 1000kg	Pronesi ose me qera	1 copë
9	Mini fadrome me kove para me goma	Pronesi ose me qera	1 cope
10	Tokmak dheu	Pronesi ose me qera	1 cope
11	Fadromë Kovë përpara dhe mbrapa	Pronesi ose me qera	1 cope
12	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes jo me pak se 20 ton,	Pronesi ose me qera	3 cope
13	Kamion vetëshkarkues me masë maksimale të autorizuar (10-12) Ton	Pronesi ose me qera	2 copë
14	Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes 8-10 ton	Pronesi ose me qera	3 cope
15	Kamion veteshkarkues me vinxh me kapacitet mbajtes mbi 6 ton	Pronesi ose me qera	2 copë
16	Kamiocine kapacitet me kapacitet mbajtes 1.5-2 ton	Pronesi ose me qera	2copë
17	Kamiocine kapacitet me kapacitet mbajtes 3.5-5 ton	Pronesi ose me qera	2copë
18	Autovinc me kosh	Pronesi ose me qera	2 copë
19	Damper me goma me kapacitet mbajtes 4-6 ton (mjet teknologjik me goma)	Pronesi ose me qera	2 copë
20	Damper me goma me kapacitet mbajtes 20-28 ton (mjet teknologjik me goma)	Pronesi ose me qera	2copë
21	Autobot uji min 5000l	Pronesi ose me qera	1 copë
22	Depozite uji 5000 l	Pronesi ose me qera	2copë
23	Autopompe betoni	Pronesi ose me qera	2 copë
24	Autobetoniere	Pronesi ose me qera	4 copë
25	Betoniere kantieri 0.25-0.5 m3	Pronesi ose me qera	2 copë

26	Helikopter nivelues	Pronesi ose me qera	1 copë
27	Pompe suvatimi	Pronesi ose me qera	1 copë
28	Vibrator betoni	Pronesi ose me qera	4 cope
29	Autosonde per shpim pilotash me diameter min 350mm	Pronesi ose me qera	1 copë
30	Palankola metalike	Pronesi ose me qera	10 ton
31	Paisje per largimin e ujerave nentoksore me sistem gjilperthithese (Sistemi Well Point i paisur me pompe thithese ,age ,kolektor dhe aksesori bashkues)	Pronesi ose me qera	1 set
32	Pompe per largim ujerash	Pronesi ose me qera	1 cope
33	Tranxhe për perpunimin e hekurit të ndertimit	Pronesi ose me qera	1 copë
34	Saldatrice	Pronesi ose me qera	1 cope
35	Gjenerator / Motogjenerator	Pronesi ose me qera	1 copë
36	Kompresore	Pronesi ose me qera	1 copë
37	Kontenier ndertimi stacionar (zyre)	Pronesi ose me qera	1 copë
38	Paisje topografike Totalstation/GPS	Pronesi ose me qera	1 copë
39	Sistem makineri e drejtuar me lazer per realizimin e miktotuleli me diameter 300÷500mm	Pronesi ose me qera	1 cope
40	Rimorkiator per transport mjetesh me kapacitet mbajtese jo me te vogel se 50 ton + Koke terheqese	Pronesi ose me qera	1 cope
41	Armature	Pronesi ose me qera	min 2000 m2
42	Skele +Rrjete mbrojtese	Pronesi ose me qera	min 1000 m2
43	Fabrike Betoni	Pronesi, me qera ose aktmarreveshje furnizimi	1 copë
44	Pirun teleskopik me krahe hapje mbi 20m me rrotullim 360° (mjet teknologjik)	Pronesi ose me qera	1 cope

45	Vincat kull mbi 11 kate	Pronesi ose me qera	1 copë
----	-------------------------	---------------------	--------

Si deshmi per plotesimin e kesaj pike Operatori duhet te paraqese:

- *Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme).*
- *Për mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit ne Republikën e Shqiperisë ose faturat tatimore te blerjes.*
- *Për te gjitha mjetet e marra me qera, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qerasë ku të specifikohet afati i kontratës dhe objekti.*
- *Per mjetet e marra me qera qe shenohen ne rregjistra publik, duhet te paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikata për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Kurse per mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre, aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.*
- *Per te gjithë mjetet dhe paisjet e kerkuara te shoqerohen me foto.*
- *Operatori ekonomik duhet te deklaroje vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera me anë të një deklarate të firmosur dhe vulosur nga Administratori, me qëllim te verifikimit nga Autoriteti Kontraktor*
- *Fabrika prodhimi i betoni duhet te paraqesin dokumentacionin e pronesise/kontraten e qirase/kontraten e furnizimit. Ne rast se fabrika eshte ne pronesi/qira duhet te paraqitet edhe leja mjedisore leshuar nga QKL Kodi III.1.B. Ne rast se do te paraqitet kontrate furnizmi OE nuk detyrohet te paraqese lejen mjedisore leshuar nga QKL Kodi III.1.B.*

Ne rast se operatori ekonomik nuk disponon mjet Rimorkiator per transport mjetesh –mund te paraqese kontrate bashkepunimi te vlefshme per gjithë periudhen qe zgjasin punimet.

Argumentimi: *Mjetet e mësipërme kërkohen: duke u bazuar në proceset e punës, volumet e punimeve të preventivit të kryera gjatë periudhës më të ngarkuar (pikut) duke marrë parasysh gjithashtu edhe kombinimet e mundshme të punës se mjeteve në kantiere ne te cilët është e shpërndarë puna objekt prokurimi.*

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në

dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas

- VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve” dhe Udhëzimit nr.2, datë 08.05.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë licence lidhur me ndikimin në mjedis të lëshuar nga QKL kodi III.2.B “Grumbullim dhe transportim i mbetjeve të llojeve të ndryshme” III.2.B “Grumbullim dhe transportim i mbetjeve të ujrave të ndotura urbane, llumrave septike dhe ujrave të zeza” duke përfshirë kodet 20 03 04 ,19 13 04 ,19 13 06.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë licence kodi III.2.B sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme janë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “c” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

Per sa i takon kërkeses për Lejen Mjedisore me Kod III.2.B “Grumbullim dhe transportim të mbetjeve të llojeve të ndryshme” bazohet në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku specifikohet se : “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Gjithashtu ky kriter është vendosur bazuar në Ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, bazuar në Nenin 5 “Mbrojtja

e shëndetit të njeriut dhe mjedisit”, në Ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, si dhe referuar raportit teknik dhe Specifikimeve teknike të projektit objekt prokurimi dhe kompleksitetit të kontrates, metodat e punës që duhet të aplikohen nga zbatuesi duhet të synojnë në minimizimin ose nëse është e mundur në ndalimin e cenimeve ndaj mjedisit dhe duhet të tregojë një kujdes maksimal në transportin e mbetjeve inerte që dalin gjat punimeve dhe germimeve si transportin e tyre, me qëllim mbrojtjen maksimale të mjedisit dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar si dhe është bazuar në projekt-preventivin.

2.4.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata.

- a. Certifikat: ISO 9001/2015 -Sistemi i Menaxhimit të cilësisë, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: *Kjo certifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarte të cilësi, e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.*

- b. Certifikat: ISO 45001 : 2018 - Sistemi i menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në vendet e punës, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: *Sistemi i menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në vendet e punës mundëson që çdo kompani duhet të mbrojtë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.*

- c. Certifikat: ISO 14001:2015-“Sistemet e menaxhimit të ambientit” e vlefshme, ose ekuivalente.

Argumentimi: *ISO 14001:2015 është një standard ndërkombëtar që ka të bëjë me menaxhimin e mjedisit dhe përmbushjen e kërkesave ligjore dhe rregullatore për mbrojtjen e mjedisit. Kjo*

certifikatë siguron që kompania ndërtuese ka implementuar praktika dhe sisteme për të menaxhuar ndikimet mjedisore të punimeve, si ndotja e ajrit, ujërave dhe menaxhimi i mbetjeve.

2.4.3 Për Listën e mallrave/ materialeve të përcaktuara në Preventivin objekt prokurimi, listën si më poshtë:

– **Hekur**

Kur operatorët ekonomikë janë prodhues të paraqitet katalogu përkatës, leje mjedisore kodi certifikatëne cilësisë ISO 9001/ekuivalente e vlefshme. Kur operatorët ekonomikë nuk janë vetë prodhues të paraqitet dhe kontrata paraprake e furnizimit evlefshme.

Për rastin kur autorizimi do të jetë lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet te shoqerohet edhe me dokumentacionin qe verteton lidhjet e firmes prodhuese me distributorin (kontratë/autorizim).

– **D/Alumin Plastik Dopio xham**

Per produktin te paraqiten katalog ku te specifikohen qarte te dhënat e materialit. D/Alumini plastik te jene te pajisur me certifikata konformiteti dhe me testime laborator sipas EN 14351 1:2006+A2:2016-09.Te paraqitet Performanca e xhamit sipas rezultatit te kalkulimeve per Termiken sipas EN 673.Testimet per rezistencën ndaj ajrit me testimet sipas metodës EN 12211 dhe durimit ndaj ujit sipas metodës EN 1027.

– **Polisteroli**

Polisteroli 10 cm sipas standartit EN13163:2012. Per produktin te paraqiten katalog ku te specifikohen qarte te dhënat e materialit.Pajisur me AVCP sipas EN 13163:2012 per verifikimin e performances se produktit sipas EN 13163:2012. Reagimi nga zjarri performanca NPD testimi sipas standartit EN 13501-1.Forca ne shtypje sipas performances CS (10/Y) 102.5 sipas testimit me standart EN826.Gjithasthu per produktin te paraqitet ISO 9001 e prodhuesit.

– **Boje hidroplastike**

Boje hidroplastike Konformiteti ose Raport Testimi sipas SSH EN 11998 (percaktimi i aftesisë për t'u pastruar e veshjeve/shtresave të holla të lyrjes) dhe Certificate qe verteton se boja qe do te aplikohet eshte Antimikrobiale/antibakteriale .

– **Hidroizolues me baze cemento**

Hidroizolues me baze cemento, pergatitur nga dy komponente A+B: Certificate Konformiteti ose Raport Testimi sipas SSH EN 7783 (përcaktimi i vetive së përhapjes ujë-avull).

– **Ashensor**

Per Ashensoret OE duhet te paraqese katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe te paraqiten çertifikatë/deklaratë konfirmimit CE, certifikatat e cilesise ose raportet e testimi nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike. Ashensoret duhet te jene sipas standartit EN81-20/50.

– **Materiale elektrike, hidraulike**

Per produktin te paraqiten katalog ku te specifikohen qarte te dhënat e materialit.

- **Operatori** ekonomik duhet te kete Autorizim te Prodhuesit/ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi/Marrëveshja e bashkëpunimit duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, website, e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Ne rast te disponimit te autorizimit te prodhuesit ne gjuhe te huaj, ky dokument të paraqitet i perkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese autorizimin e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

– **Operatori** ekonomik duhet te kete kontrate me nje laborator testimi te betonit, hekurit dhe pllakave te gurit, i cili duhet te jete i akredituar nga organizma kombetar ose nderkombetar sipas standarteve SSH EN 12390-3:2019 ose ekuivalent, SSH EN 12350-2:2019 ose ekuivalent, SSH EN 12504-2:2012 ose ekuivalent, SSH EN ISO 6892 – 1:2019 ose ekuivalent, SSH EN 1341:2012, SSH EN 1926:2006, SSH EN 1342:2012 SSH EN 196- 2:2013, SSH EN 196-6:2018 Persa me siper duhet te paraqitet:

- Kontrata noteriale sherbimi me laboratorin testues perkates
- Certifikata e akreditimit te laboratorit testues perkatës

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Nenin 39, pika 8, si dhe në bazë të Nenit 44, pika 1 të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar). Operatori ekonomik bazuar në preventivin e punimeve objekt kontrate, ku përveç vendosjes është parashikuar dhe furnizimi i materialeve, referuar natyrës së tyre, ku disa prej tyre duhet të jenë të një cilësie të mirë, referuar kostos së tyre dhe funksionit që kanë, me qëllim që të kenë një jetëgjatësi përtej periudhës së garancisë që kanë, vlerëson se operatorët ekonomik duhet të paraqesin dokumentacionin që vërteton lidhjen me prodhuesin ose distributorin e

autorizuar nga do t'i sigurojnë këto materiale objekt kontrate, katalogët e pajisjeve/ materialeve si dhe dokumentacionin me të dhënat e këtyre materialeve, me qëllim verifikimin/ vlerësimin nga A.K., nëse këto materiale/ pajisje për të cilat do të ofertojnë operatorët ekonomik pjesëmarrës janë në përputhje me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat e tenderit, si dhe janë të prodhuara nga prodhues të çertifikuar për prodhimin e tyre me cilësi dhe brenda standarteve të miratuara. Kjo kerkese është kërkuar që ti sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshem Teknik dhe ploteson specifikimet e kërkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontrates.

Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga punimet/shërbimet që parashikohen të realizohen në preventive si dhe për shkak të interesit të lartë që ka objekti duhet të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane. Prandaj e gjejkojmë të domosdoshme të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane, që OE ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar vetëm pajisje origjinale me garanci, si dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të bërë krahasueshmërinë e materialeve të ofruara nga operatori me ato të kërkuara në dokumentat e tenderit.

2.4.4 Vetëdeklarim, sipas deklaratës në vijim, ku të evidentohen objektet dhe vlerat përkatëse të kontratave, nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/ nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “periudhë” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit.

DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROÇES

(Për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik)

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj se kam në proçes dhe/ose jam shpallur fitues për kontratat e mëposhtme:

Nr.	Autoriteti kontraktor	Objekti i procedurës së prokurimi/kontratës	Vlera e shpallur fituese

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në zbatim të parashikimeve ligjore të Kreut III, të VKM nr.42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku parashikohet:

b) Subjektet e licencuara në zbatim nuk mund të kualifikohen si fituese për punë publike të prokuruar sipas ligjit të prokurimit publik nëse janë fitues dhe/apo kanë në proces në të njëjtën kohë si kontraktor/nëkontraktor një investim sipas një kontrate të lidhur/apo në proces për t’u lidhur sipas ligjit për prokurimin publik me vlerë të përbashkët ose të veçantë që tejkalon vlerën e kategorisë që mban subjekti sipas lidhjes 4. Subjektet e licencura kanë të drejtë të marrin pjesë/apo të shpallen fituese në prokurime publike, brenda të njëjtës periudhë deri në vlerën e licencës së përcaktuar sipas lidhjes 4. Në kuptim të kësaj shkronje fjala “periudhë” kupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas ligjit për prokurimin publik nga momenti i shpalljes fitues deri në kolaudim të objektit/investimit. Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoritetet kontraktore, sipas ligjit për prokurimin publik, hartojnë dokumentet standarde të tenderit dhe dokumentet e tenderit në përputhje me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara këtu me detyrimin që kur verifikohet se subjekti përfshihet në investime që tejkalojnë klasën e kategorisë së licencuar sipas lidhjes 4, kontrata të shpallet absolutisht e pavlefshme me detyrimin për njoftim për nisje të procedurës për heqje licence.

2.4.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- PLAN - ORGANIZIMIN e punimeve të objektit ku te reflektoje te gjitha masat teknikoorganizative dhe elementet e tjere qe kerkon nje plan organizimi i mirëfilltë.
- PLANIN E SIGURISE NE KANTIER per punimet ne objekt ne format sipas VKM nr. 692 date 13.12.2001 “Per masat e vecanta te sigurimit dhe ruajtjes se shendetit ne pune, te ndryshuar me VKM nr. 742 date 06.11.2003”, sipas kerkesave, si rrethimi provizor, depozitimi i materialeve kryesore, ambientet e kantierit, rruge kalimet, tabelat e sig. teknik etj.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 3 është e lidhur me kërkesat teknike mbi menyren me grafikun e punimeve; fazat si dhe afatet e realizimit te punimeve.

2.4.6 Afati i kryerjes së punimeve:

Operatori ekonomik duhet të paraqesi grafikun e punimeve në përputhje me afatin kohor që është lënë në dispozicion për realizimin e kontratës.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të nenin 15 pika 3/a të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash parashikohet se: **“a) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën: - grafikun e zbatimit;”**

Grupi i hartimit të specifikimeve referuar të dhënave teknike në projektin e hartuar nga projektuesi ku parashikohet dhe afati i kryerjes së punimeve bazuar në grafikun e punimeve, vendosi miratimin e afatit të punimeve prej 24 (njetzet e kater) **muaj nga data e lidhjes së kontrates**, vlerësuar si afat i mjaftueshëm për realizimin e kryerjes së punimeve objekt prokurimi.

Grupi i specifikimit kërkon kriteret për kapacitetet profesionale e teknike si më lart duke qënë se këto kriteret janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Por edhe sepse mbi të gjitha ato i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet Teknike për procedurën respektive janë hartuar nga drejtoria e projekteve, pjesë perberese e strukture së Bashkisë Durrës, që ka hartuar edhe projektin ide të zbatimit duke qënë elemente perberes të tij. Në hartimin e tyre janë marrë në konsiderat kërkesat ligjore të fushës së planifikimit dhe zhvillimit të territorit si dhe normat perkatese të Ligjit nr. 9290, datë 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit” i ndryshuar dhe Vendim i KM nr.312, datë 5.5.2010 Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, Vendim i KM nr. 448, datë 31.7.2025 "Për miratimin e rregullores së zbatimit të punimeve të ndërtimit dhe të rregullave të kantierit" si dhe kërkesat e ligjit të Ligjit Nr. 10480 datë 17.11.2011, "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore". Specifikimet Teknike janë pjesë e setit të dokumentave të ngarkuara në SPE për procedurën respektive.

Fondi Limit i perlllogaritur për këtë procedurë është hartuar në bazë të Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.

- VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve”

- Udhëzimi nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.,

VKM Nr. 354 ,datë 11.5.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”

Kujdes! Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Shënim: Në çdo kërkesë te preventivit ku është shënuar marka e materialit shtohet fjale “ekuivalente e saj”.

Në specifikimet teknike, AK i është referuar standardeve ndërkombëtare EN, fakti që ekzistojnë standard ndërkombëtare të adoptuara në ato kombëtare nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, vlerësojmë që për standardet e mësipërme, ne si AK pranojmë edhe mundësinë e paraqitjes së standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardit europian dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Sipas specifikimeve bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përllogaritur nga projektuesit dhe ku janë mbështetur strukturat të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Specifikime teknike, projekti, preventivi, grafiku dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT.

Dokumentet e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarët e njësisë kane akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP (www.app.gov.al).

Njësia e prokurimit